

VENDIM
Nr. 222, datë 13.4.2022

PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA PROJEKTI “ZGJERIMI I SIPËRFAQEVE TË VARREZAVE PUBLIKE TUFINË, FAZA 2”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti “Zgjerimi i sipërfaqeve të varrezave publike Tufinë, faza 2”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Tiranë.

3. Pronarët kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë e llojit “arë”, me një vlerë të përgjithshme prej 5 829 376 (pesë milionë e tetëqind e njëzet e nëntë mijë e treqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 5 829 376 (pesë milionë e tetëqind e njëzet e nëntë mijë e treqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekësh, përballohet nga buxheti i miratuar për Bashkinë Tiranë.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohen nga buxheti i miratuar për Bashkinë Tiranë.

6. Shpronësimi i pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7. Pronarët e pasqyruar në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi kanë paraqitur dokumentacionin për likuidim, certifikatën e pronësisë, kartelën e pasurisë, si dhe hartën treguese të regjistrimit pranë Bashkisë Tiranë.

8. Bashkia Tiranë kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Tiranë.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore, Tiranë Rurale 1, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë, fillon procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe bën regjistrimin e kalimit të pronësisë për pasuritë e shpronësuar në favor të Bashkisë Tiranë.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Rurale 1, pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistrimi i kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Tiranë.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin, Bashkia Tiranë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Rurale 1, dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrotjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut të Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

**LISTA EMËRORE E PRONARËVE PRONË PRIVATE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I PROJEKTIT “ZGJERIMI I
SIPËRFAQEVE TË VARREZAVE PUBLIKE “TUFINË”, FAZA 2**

Nr.	Pronari			Të dhëna kadastrale								Vlerësimet për shpronësim				Shënime (kufizime hipotekare barre mbi pasurinë etj.)
	Emër	Atësia	Mbiemër	Qyteti	Z. kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip. totale Arë/vrësht/pemëtore (m²)	Arë/vrësht/pemëtore (m2)	Vol	Faqe	arë/vrësht/pemëtore			Vlera totale (lek)	
												Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë / m²)	Vlera (lekë)		
A	B	C	D	E	F	G	H	I	J	K	L	M	N	O	P	Q
1	Qazim	Veli	Daja	Tiranë	3426	26/6	Arë	620	620	1	4	501	448	224,448.00	224,448.00	
2	Qafile Lulzim	Reshit	Daja; Daja	Tiranë	3426	26/58	Arë	1676	1676	7	144	1650	448	739,200.00	739,200.00	
3	Ali	Haxhi	Daja	Tiranë	3426	26/31	Arë	500	500	6	58	500	448	224,000.00	224,000.00	
4	Bashkim	Nezir	Hasmeta	Tiranë	3426	26/65	Arë	3600	3600	7	196	3001	448	1,344,448.00	1,344,448.00	
5	Eqerem	Selman	Lala	Tiranë	3426	26/61	Arë	1330	1330	7	192	1330	448	595,840.00	595,840.00	
6	Ali	Haxhi	Daja	Tiranë	3426	26/32	Arë	600	600	60	59	600	448	268,800.00	268,800.00	
7	Ali	Haxhi	Daja	Tiranë	3426	26/33	Arë	1500	1500	6	60	1500	448	672,000.00	672,000.00	
8	Fatime; Besnik; Hasan; Edmond; Lindita Shqipe	Rustem; Xhelal; Xhelal; Xhelal; Xhelal; Xhelal	Shima	Tiranë	3426		Arë					3771	448	1,689,408.00	1,689,408.00	
9	Qamil	Selman	Lala	Tiranë	3426	26/63	Arë	2060	2060	7	194	40	448	17,920.00	17,920.00	
10	Kadri		Cakmaku	Tiranë	3426	26/60	Arë	873	873	7	146	119	448	53,312.00	53,312.00	
												13012		Shuma	5,829,376.00	
1. Për tokën bujqësorë, çmimi i llogaritur është marrë nga VKM nr. 89, datë 3.2.2016.																